

ATLAS TRADING SHPK

Rruge "Tish Dahia, Kompleksi Kika 2, Kulla 2, Nr. 33, Tirane".

STATUTI

Kapitulli I EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 *Emërtimi*

Nëpërmjet këtij akti, sot në datën 6 Dhjetor 2023, është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "ATLAS TRADING" shpk.

Shoqëria është person juridik shqiptar sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislatacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë statut.

Neni 2 *Selia dhe kohëzgjatja e shoqërisë*

Shoqëria e ka selinë në Rrugë "Tish Dalia, Kompleksi Kika 2, Kulla 2, Nr. 33, Tirane". Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Kohëzgjatja e Shoqërisë është përcaktuar 20 vjet.

Neni 3 *Objekti*

Shoqëria ka për objekt të saj Import-eksport dhe shitje me pakicë e shumicë të pjesëve të këmbimit përmjet dbe makineritë e rënda dhe automjetet. Tregtim varjash lubrikante, filtra te ndryshem. Import- eksport, tregti mjeteteve të transportit dhe makinerive të ndryshme.

Neni 4 *Mbi Themeluesin*

Shoqëria themelohet nga ortakët si më poshtë:

1. Charalampos Tsokanis, i biri i Evangelos, i datelindjes 6 Janar 1984, banues ne Athine, Greqi
2. Charalampos Tsokanis, i biri i Theodoros, i datelindjes 26 Shtator 1975, banues ne Athine, Greqi
3. Charalampos Tsokanis, i biri i Theofilos, i datelindjes 6 Shkurt 1982, banues ne Athine, Greqi
4. Konstantinos Tsokanis, i biri i Theodoros, i datelindjes 4 Korrik 1977, banues ne Athine, Greqi
5. Vasiliki Tsokani, e bija e Theofilos, e datelindjes 28 Tetor 1987, banuese ne Athine, Greqi

Në përputhje me Ligjin "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe me dispozitat e këtij statuti, në Shoqëri mund të përfshihen dhe ortakë të tjera, të cilët bëhen zotërues të pjesëve të caktuara të kapitalit.



Kapitulli II

KAPITALI DHE KUOTAT

Neni 5 *Mbi Kapitalin Themeluar*

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 300,000 lekë dhe ortaket zoterojne kuotat e kapitalit si me poshte:

1. Charalampos Tsokanis, i biri i Evangelos, i datelindjes 6 Janar 1984, zoteron një kuotë në vlerën 100,020 lekë që përbën 33.34% te kapitalit.
2. Charalampos Tsokanis, i biri i Theodoros, i datelindjes 26 Shtator 1975, zoteron një kuotë në vlerën 50,010 lekë që përbën 16.67% te kapitalit.
3. Charalampos Tsokanis, i biri i Theofilos, i datelindjes 6 Shkurt 1982, zoteron një kuotë në vlerën 50,010 lekë që përbën 16.67% te kapitalit.
4. Konstantinos Tsokanis, i biri i Theodoros, i datelindjes 4 Korrik 1977, zoteron një kuotë në vlerën 49,980 lekë që përbën 16.66% te kapitalit.
5. Vasiliki Tsokani, e bija e Theofilos, e datelindjes 28 Tetor 1987, zoteron një kuotë në vlerën 49,980 lekë që përbën 16.66% te kapitalit.

Asambleja e ortakeve vendos përritjen apo zvogelimin e kapitalit themeltar si dhe per shperndarjen e fitimeve.

Kapitulli III

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 6 *Asambleja e Ortakve*

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve irregullisht e thirrur, përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe vendimet e saj të marra sipas ligjit dhe sipas këtij Statutit.

Asambleja e ortakëve mblidhet të paktën një herë në vit, brenda javës së tretë të muajit Maj. Administratori drejton mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve.

Neni 7 *Organë Ekzekutiv*

Organë ekzekutiv i shoqërisë është Administratori.

Administrator i shoqërisë emërohet Znj. Iva Kapoli për një periudhë 3 vjeçare.



Kapitulli IV **PASQYRAT FINANCIARE DHE DIVIDENDËT**

Neni 8

Viti ekonomik fillon në 1 Janar dhe mbylljet në 31 Dhjetor të çdo viti dhe Pasqyrat Financiare duhet të miratohet brenda gjashtë muajve që vijojnë.

Përjashtimisht, viti i parë ekonomik fillon në datën e rregjistrimit në rregjistrin tregtar dhe mbylljet në 31 Dhjetor 2023.

Neni 9

Në mbyllje të çdo viti ekonomik, organi administrativ, brenda tre muajve duhet të proçedojë në përgatitjet e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë të cilat përkruajnë më së miri glendjen fuançiare, performancën, ndryshimet në gjendjen e kapitalit dhe flukset e parasë.

Pasqyrat Financiare duhet të shoqërohen nga një relacion i organit ekzekutiv që bën të qartë ecurinë e administrimit në sektorë të ndryshëm në të cilët Shoqëria ka vepruar, edhe me shoqërëtë e tjera që kontrollohen prej saj, me një kujdes të veçantë si për investimet, për kostot dhe për çmimet ashtu edhe për faktet me rëndësi që janë vërtetuar pas mbylljes së veprimtarisë.

Neni 10

Pasqyrat Financiare dhe relacioni i organit ekzekutiv duhet të mbeten të depozituar pranë selisë së Shoqërisë 15 ditë para mbledhjes së Asamblesë të ortakëve që thirret për t'i aprovuar ato, gjatë së cilës ortakët mund të kërkojnë e të shqyrtojnë kopje me shpenzimet e tyre.

Këto dokumenta duhet të janë në dispozicion të ekspertëve kontabël të regjistur në qoftë se janë të emerëruar, të paktën 40 ditë para mbledhjes të Asamblesë së Ortakëve që duhet t'i aprovojnë.

Neni 11

Të ardhurat neto duhet ti shpërndahen ortakëve si dividend, përashto rastin kur Asambleja e Ortakëve vendos për destinime të tjera.

Pagesa e dividendëve duhet të bëhet duke hyrë në fuqi nga data e caktuar nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve që ka vendosur shpërndarjen e tyre.

Në mungesë të përcaktimit të datës së pagesës së dividendëve, këta do të janë në dispozicion të ortakëve pranë arkës së selisë së Shoqërisë që nga dita e 30 pas marrjes së vendimit të shpërndarjes së dividendëve.

Dividendët që nuk janë tërhequr brenda pesë vjetëve duke filluar nga dita që janë bërë të pagueshëm parashkuhen në fondin e Shoqërisë dhe kalojnë në fondin rezervë.



Kapitulli V
DISPOZITA TË TJERA

Neni 12

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

Neni 13

Për ato që nuk janë shprehur në këtë Statut do të bëhet referim me dispozitat e Ligjit në fuqi.


Ky Satut është hartuar në 5 (pese) kopje origjinale.

Ortaket Themelues



Charalampos Tsokanis

Charalampos Tsokanis



Charalampos Tsokanis

Konstantinos Tsokanis



Vasiliki Tsokani

